



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikës dhe Financa, mbajtur më 22.05.2018,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: **Agim Kuleta**, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: **Genc Sherifi**, **Vala Peshku**, **Halim Halimi**, **Agim Gashi**, **Blerand Stavileci**, **Jeta Rafuna**, **Eman Rrahmani**, **Fadil Gashi** dhe **Egzon Azemi**.  
Mungoi: **Sami Boroci**.

Në mbledhje morën pjesë edhe: **Valbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, **Fatos Dibra**, përfaqësues i Zyrës ligjore, **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, **Yll Rugova**, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, **Teuta Hoxha - Jahaj**, përfaqësuese e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe **Admir Shala**, përfaqësues nga INPO.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutim për rendin e ditës, kryesuesi i njoftoi të pranishmit rreth ndryshimit të rendit të ditës.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

**Dren Kukaj** tha se lidhur me një pikë që e kemi, Zyra ligjore do të na shpjegoi më mirë, e cila ka të bëjë me një këmbim të pronës në Lagjen e Muhaxhirëve, që është në kuadër të zhbllokimit të lejeve ndërtimore, ku dhe obligohet që Drejtoria e Urbanizmit të na sjellë informata më të detajuara.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke cekur se është fjala për një këmbim që ka ardhur me vonesë në Zyrën ligjore. Është këmbim që bëhet për interes publik për ndërtim të rrugës.

**Fadil Gashi** tha se për këtë propozim është dashtë që drejtoria përkatëse të na sjellë informacionin e sakët se ku ndodhet ajo parcelë.

**Agim Gashi** theksoi se në rastet kur kemi pika të tilla për shqyrtim, është më se e domosdoshme që përfaqësuesit nga Drejtoria e Urbanizmi të na japin sqarime të sakta. Në parim, këtë propozim e përkrahim, por deri në mbledhjen e Kuvendit të na sillen informata të plota.

**Halim Halimi** tha se këtë propozim e përkrahim, por kërkojmë që për mbledhjen e Kuvendit materiali të jetë i përgatitur.

**Genc Sherifi** theksoi se ky material ka ardhur pak me vonesë dhe nuk mundemi me lexuar komplet dokumentin, me analizuar, por shpresojmë se herëve të tjera të na sillen me kohë.

**Agim Kuleta**, kryesues, propozoi që ky propozim të futet si pikë e shtatë e rendit të ditës.

**Osman Bllaca** propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, kërkesa e Ambasadës franceze në Prishtinë, që ka kërkuar caktimin e një lokacioni për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francez të KFOR-it.

**Halim Halimi** u shpreh në përkrahje të kësaj pike të rendit të ditës për Kuvend.

**Eman Rrahmani** tha se ndikimi i ushtarëve francez, sidomos i KFOR-it, nuk është i madh, përveç që ka ndikuar shumë jashtëzakonisht në ndarje të Mitrovicës, nuk ka ndonjë ndikim të madhe në çështje politike.

**Agim Kuleta**, kryesues, propozoi që të futet kjo pikë si pikë e tetë e rendit të ditës për Kuvend: **“Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it”**.

**Vala Peshku** tha se në mbledhjen e parë të mbajtur të Komitetit për Politikë e Financa, ka qenë me rëndësi Vendimi i MAPL-së për raportin gjinor të KPF-së. Ne në mbledhjen e fundit të Kuvendit e kemi bërë një ndërrim, se kanë hyrë dy përfaqësues, që të dytë janë meshkuj, e kisha ngrit këtë çështje se nëse ne e kemi larguar një grua e kemi zvogëluar numrin dhe tash ka hy prapë një burrë.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga znj. Peshku, **Agim Kuleta**, kryesues, dha sqarime.

**Eman Rrahmani** tha se e kam propozuar Vjosën, por nuk ka pranuar.

**Vala Peshku** tha se për mos me ardhur deri te kthimi prapë nga MAPL-ja, është mirë me diskutuar këtë çështje.

**Agim Kuleta**, kryesues, tha se do ta diskutojmë këtë çështje.

Po ashtu, është edhe një kërkesë, fjala është për një investim prej 50 milionë për një qendër sportive për sporte marciale, ku Qeveria japoneze është në negociata me UNDP-në, ku ata kanë kërkuar 4-5 hektar pronë, dhe drejtori i Pronës i ka siguruar 3 parcela te Fabrika e tullave, por ajo ishte e AKP-së nuk është e Komunës. Mirëpo unë do të takohem me ta dhe do t'iu prezantoj këto prona dhe të shohim a janë dakord ata për këto lokacione.

Kërkoj mendimin tuaj, nëse mundemi me proceduar dhe nëse është urgjente, a mund ta fusim si pikë të rendit të ditës në ndërkohë.

**Agim Gashi** tha se kjo nuk varet nga ne, por kjo varet nga Drejtoria e Pronës, se a është e gatshme për Kuvend me përgatitur propozimin, në parim është mirë me e përkrahur.

**Agim Kuleta**, kryesues, tha se çështjen e lokacionit do ta bisedojmë me AKP-në.

**Dren Kukaj** dha **Fatos Dibra** dhanë sqarime të nevojshme lidhur me këtë kërkesë.

**Agim Kuleta**, kryesues, tha se në bazë të sqarimeve të parafolësve për mbledhjen e ardhme nuk paska mundësi të përgatitet, por kjo mbetet si çështje e ngritur.

**Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, me dy propozimet e paraqitura, dhe konstatoi se u miratua ky:**

## REND I DITËS :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimrregullorja për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës;
3. Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat , vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;
4. Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim;
5. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it;
9. Të ndryshme.

### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Agim Gashi bëri vërejtje në ekstrakt, duke cekur se përshkruesit e ekstraktit të jenë të kujdesshëm në formulimin e fjalive, se ndoshta në këtu kurë flasim herë-herë lëshojmë gabime gjuhësore, por jo edhe logjike, mendoj bëjmë lëshime në formulimin e fjalive, mirëpo është mirë atje të formulohen më drejt.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

### Pika e dytë

Propozimrregullorja për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës.

Agim Kuleta, kryesues, tha se në rend dite është fjala "vetanake", në dokument "vetjake", duhet me rregulluar këtë term.

Blerand Stavileci tha se është drejt e shkruar "vetjake", se "vetanake" nuk ekziston në gjuhën shqipe, në fjalorin shqip përveç "vetjake" nuk ka tjetër.

Agim Gashi tha çështjet që i parasheh fjalori, duhet me i zbatuar.

**Yll Rugova** unë e kam trashëguar këtë term, por, megjithatë ne e dimë se ky fjalor mbetet ai i viteve të 70-ta, unë po besoj se ky term nëse nuk është në fjalor, të futet në një version të ri të fjalorit.

Sa i përket **Propozimrregullores për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës**, në pika të shkurta e prezantoi drejtori i Drejtorisë së Kulturës, z. Yll Rugova.

**Halim Halimi** kërkoi sqarime nga drejtori për nenin 7.1.8, pagesat sipas shërbimeve të institucioneve, të hyrat nga certifikata me nota, dhe pika 7.1.9, të hyrat nga certifikata pa nota, për çfarë certifikata bëhet fjalë.

**Yll Rugova** tha se i kemi ftuar të përfaqësuesit e Arkivit Komunal dhe i kem pyet cilat janë shërbimet që i ofrojnë ata, dhe këto kanë figuruar në listë e shërbimeve që ata i ofrojnë.

**Agim Gashi** tha se nëse Arkivi ju ka dërguar listën e dokumenteve që procedohen me pagesë në shërbim të qytetarëve, ne s' mund ta ndryshojmë, ne mund të kërkojmë sqarime nga ata që të vinë në Kuvend dhe ta bëjnë sqarimin se ku është dallimin në mes tyre.

**Osman Bllaca** bëri vërejtje, duke thënë se për Rregulloren për të hyrat është mirë me qenë tarifa e caktuar për të gjitha shërbimet që bëhen, se për shkak se për tarifa zakonisht duhet me u marrë vendim sovran, nëse veprohet në këtë mënyrë, që nuk është edhe jo ligjore, ju jepet e drejta katër institucioneve vartëse që ato vetë të veprojnë me çmimin e tyre, e që ne si Komunë nuk e kemi kontrollin.

**Agim Gashi** tha sa kemi miratuar Rregullore edhe për institucione të kulturës, por të shihet a është e përbashkët me të Arsimit.

**Yll Rugova** tha se jo, por ka qenë në Kuvend në vitin e kaluar për diskutim publik.

**Fatos Dibra** tha se është miratuar për diskutim publik.

**Vala Peshku** u shpreh e pajtimit me z. Bllaca për punën e pagesës. Po ashtu, parashtroi një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës. Nëse drejtoria e Bibliotekës i cakton çmimet, tarifat vetë dhe kemi ankesa prej ndonjë qytetari, si do ta rregullosh atë punë nëse ti nuk ke kontroll në tarifa, se ato po mbeten në kompetencë të bibliotekës?

**Yll Rugova** tha se edhe ata janë njerëz profesionalistë që merren me këtë punë.

**Osman Bllaca** tha se edhe për Rregulloren për të hyrat e Arsimit kemi vepruar kështu, iu kemi caktuar tarifat, andaj po e jap si propozim dhe ide, që i kam parë edhe në rregullore tjera dhe janë të përcaktuara kështu, dhe në Kuvend i kemi sjellë çdo herë dhe i kemi caktuar çmimet.

**Blerand Stavileci** u interesua të dijë se a janë pjesë e rregullores, apo bëhet edhe një rregullore e re për lartësinë e tarifave, se te pagesat për shërbimet e institucioneve vetëm po i tregon cilat janë pagesat të cilat i marrin këto institucione. Këtu vetëm pe tregon llojin, tash p.sh. te secila me treguar edhe tarifën me bërë një nen të ri apo me bërë një rregullore të re.

**Eman Rrahmani** tha se është problem, nuk janë çmime të pandryshueshme, janë çmime që ndryshohen si biletat për teatër, është problem me bërë një çmim fiks.

**Agim Gashi** tha se çështjet janë shumë të ndjeshme, se disa veprimtari kanë karakter ekonomik -biznesi.

**Agim Kuleta, kryesues,** sa i përket kësaj çështjeje, tha se duhet parë se çka parasheh Ligji për financa të pushtetit lokal.

**Fatos Dibra** dha sqarime se çka parasheh Ligji për financa të pushtetit lokal lidhur me çështjen e tarifave.

**Blerand Stavileci** theksoi se nëse i shohim veç e veç, pa e futur këtë nenin 3.1.4, Institucionet kulturore komunale të themeluar nga Komuna e Prishtinës, Arkivi, Biblioteka dhe Teatri, Arkivi dhe Biblioteka s'kanë çfarë shërbimesh të japin, apo produkte me shfaqur, në bibliotekë vetëm ke me shkuar me u anëtarësuar. E vetmja që ndoshta është problematike për caktimin e çmimit nga Komuna është teatri "Dodona".

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u miratua Propozimrregullorja për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tretë**

**Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës.**

**Osman Bllaca** tha se kjo rregullore ka kaluar një herë për diskutim publik, por është ndryshuar se është rritur numri i bashkësive Lokale.

**Agim Gashi** tha se pasi është miratuar versioni i parë në Kuvend, duhet me bërë ndryshimin dhe këtu te rendi i ditës riformulimin.

**Osman Bllaca** tha se atëherë është quajtur Bashkësi Lokale dhe kanë vepruar 33 BL.

**Halim Halimi** theksoi se titulli ka qenë kështu: "Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës", mirëpo ne në brendi të rregullores i kemi quajtur BL, për mos me përmend këtë titull të gjatë. Tash ajo bie prej fuqie dhe kemi një rregullore të re.

**Agim Gashi** tha se nuk duhet të shfuqizohet kjo, por si praktikë juridike është e nevojshme me u ndryshuar.

**Fatos Dibra** ceku se neni 15 thotë, atë të vjetrën që është në fuqi, me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet e vjetra. Në mandatin e kaluar kjo rregullore ka dalë në diskutim publik dhe e ndryshon rregulloren e vitit 2010.

**Genc Sherifi** tha se kjo është votuar në mandatin e kaluar për me dalë në diskutim publik, diskutimi publik ka kaluar, tash e miratojmë.

**Halim Halimi,** te neni 5.5.9 thuhet: Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit, apo lagjes urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.

Unë mendoj që kryetarin e këshillit lokal duhet ta zgjedhin anëtarët e këshillit, se këshilli lokal përbëhet prej anëtarëve të cilët votohen nga tubimi me qytetarë. Po ata anëtarë të këshillit e zgjedhin njërin prej tyre kryetar Këshillit lokal, e jo prapë me qit në tubim të qytetarëve. **Eman Rrahmani** tha se ky përshkrim i këtij neni nuk është në rregull, s'ka kuptim fjalia. **Halim Halimi** propozoj që të jetë: Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Kandidati i cili fiton shumicën e votave të anëtarit të Këshillit komunal, d.m.th. Këshilli komunal prej 7 apo 9 anëtarëve zgjedh kryetarin e Këshillit.

**Yll Rugova** theksoi se është e kuptueshme që kryetari i Këshillit duhet me qenë anëtar i Këshillit, por votat i merre prej atyre që janë pjesëmarrës në tubim.

**Fatos Dibra** tha se formulimi është keq, kuptimi është ky që po thotë Ylli.

**Blerand Stavileci** dha sqarime lidhur me çështjen e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u miratua **Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërt dhe e pestë**

**Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ.**

**Agim Gashi** bëri pyetje rreth formimit të Komisionit vlerësues, se a e përcakton Rregullorja që nga numri 7 i anëtarëve të komisionit, 3 të jenë përfaqësues nga Kuvendi.

**Osman Bllaca** tha se Rregullorja thotë 3 përfaqësues duhet me qenë nga ekzekutivi, 3 përfaqësues nga Kuvendi dhe 1 nga Shoqëria civile. I kemi dy, Komisionin dhe Komitetin konsultativ, që edhe komiteti konsultativ i ka 3 përfaqësues nga Kuvendi, 1 nga ekzekutivi dhe 1 nga Shoqëria civile.

**Agim Gashi** tha se te Komisioni vlerësues të njëjtit persona propozojnë, të njëjtit kthehen e votojnë pastaj në Kuvend, a thua mos kemi konflikt këtu.

**Blerand Stavileci** pyeti se a është komisioni i përhershëm, nga momenti që janë emrat e 7 anëtarëve, tërë mandatin derisa të merret një vendim tjetër.

**Osman Bllaca** tha se puna e këtij komisioni është e ndërlidhur me mandatin e ekzekutivit.

**Agim Gashi** pyeti se a merret ky komision edhe me hapësirat para lokaleve, se edhe kjo është pronë e paluajtshme, apo merret vetëm me ndërtime, për investime etj.

**Fatos Dibra** tha se për hapësirat para lokaleve vendosin shërbimet publike, ky komision nuk merret me këto hapësira.

**Agim Kuleta, kryesues,** pyeti se si shkon procedura e caktimit të këtyre anëtarëve.

**Osman Bllaca** dha sqarime rreth përbërjes së këtyre komisioneve, ku sipas numrit të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, caktohen anëtarë të këtyre komisioneve.

Agim Kuleta, kryesues, tha se emrat e anëtarëve të këtyre komisioneve do të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan dy propozimet: Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ, dhe dërgohen në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

**Pika e gjashtë**

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

**Pika e shtatë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

**Pika e tetë**

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

**Të ndryshme**

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se po e paraqes për diskutim çështjen e Rregullores së punës, pasi që është miratuar Ligji për Prishtinën, mund të ketë ndryshime në lidhje me punën e Kuvendit të Komunës.

Besoj se ju ka ardhur një E-mail, ua kemi dërguar, është një koalicion i organizatave qeveritare që e kanë përzgjedhur Komunën e Prishtinës për të avokuar për çështje shëndeti në përgjithësi, për shëndetin riprodhues. Është çështja konkrete që kanë kërkuar një takim me ne, andaj kush ka mundësitë me ardhur nga asamblistët është i mirëseardhur.

**Vala Peshku** tha se në përdorimin e E-mailit zyrtar po kam probleme dhe kam menduar që është problem individual, mirëpo, siç po duket, shumica kanë probleme. Mendoj se është problemi teknik tek TI-a.

**Egzon Azemi** tha se në lagjen "Dardania", në rrugën "Xhemail Mustafa" disa qytetarët janë duke mbledhë një peticion, për shkak se kanë pakënaqësi me një projekt që është duke e ndërmarr Drejtorja e Investimeve Kapitale, për shkak se aty është një pjesë, rreth 30 m<sup>2</sup>, që është zonë e gjelbëruar. Me atë projekt parashihet të bëhen tri parkingje dhe një rrethrotullim, ku aty është një rrugë pa dalje dhe nuk po dëshirojnë me ndërhy në atë mënyrë, sepse aty ka pak hapësirë gjelbëruese.

**Agim Kuleta, kryesues**, tha se si peticion i shkon Drejtorisë së Administratës, pastaj drejtohet te Kryetari, kryesuesi, e diku tjetër e trajtojmë si peticion dhe duhet shikuar se ai i plotëson kushtet si peticion apo jo.

**Egzon Azemi** kam edhe një pyetje. Në mbledhjen e kaluar në një far forme jemi dakorduar se në mbledhjen e radhës të Kuvendit me qenë diskutimi për ndërmarrjet publike. Nuk e di a është diskutuar sot a jo, dhe a po mendoni se është e rëndësishme me diskutuar për këtë çështje apo jo, që me ditë pse nuk janë formuar deri tash etj.

**Halimi Halimi** tha se këtë çështje mundemi me futur si pikë të rendit të ditës në ditën e seancës.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:20.**

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**

